

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Misin Frangu me sek. juridike Ardita Tasholli, në çështjen kontestimore sipas padisë Kompania e Sigurimeve " [REDACTED] rruga " [REDACTED] në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av. [REDACTED] e kundër të paditurit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] Komuna e Ferizaj, baza e kontestit zhdantim në bazë të regresit, më datën 12.04.2016 shpallë këte:

## A K T G J Y K I M

Për shkak të padëgjushmeris/mosbindjes/

**APROVOHET**, kërkespadija e paditëses Kompania e Sigurimeve " [REDACTED] , rruga [REDACTED] në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av. [REDACTED] që **OBLIGOHET** i padituri [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna e Ferizaj, të kthejë borgjin në shumën prej 635.00 Euro/Gjashtëqindë e tridhjet e pesë euro/, në emrin të zhdantimit në bazë të regresit si dhe shpenzime e procedurës sipas llogaris që do të bëjë Gjykata në procedurë permbarimore, të gjitha këto në afatë prej 15 ditësh nga dita e plotefuqishëris së këtij Aktgjykimi, nën kanosjen e egzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Paditsja Kompania e Sigurimeve " [REDACTED] rruga [REDACTED] në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av. [REDACTED] ka paraqitur padi në këtë Gjykatë ndaj të paditurit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna e Ferizaj, baza e kontestit zhdantim në bazën të regresit në shumën prej 635.00 Euro./Gjashtëqindë e tridhjet e pesë euro/.

Gjykata në pajtim me nenin 394 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të paditurit i ka dërguar një kopje të padisë dhe udhezimin për përgjegje në padi, të cilat i ka pranuar me datën 18.02.2016. Edhe pse i padituri [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna e Ferizaj, ka qenë i obliguar që në afatin prej 15 ditësh të bëjë përgjegjëjen në padi, i njëjti nuk e ka shfrytëzuar afatin.

Për këtë arsye ka vendosur si në dispozitivin të këtij Aktgjykimi e konformë nenit 150 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, me të cilin e ka aprovuar kërkespadinë e paditëses Kompania e Sigurimeve " [REDACTED] rruga " [REDACTED] në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av. [REDACTED]

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

C.nr.505/15

Me datën 12.04.2016

Sek.juridike  
Ardita Tasholli



Gjyqtari,  
Misin Frangu

**Këshilla Juridike:** kundër këtij Aktgjykimi, palet e paknaqur mundë të ushtrojnë Ankesë në afatin prej 15 ditësh në gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmesë kësaj Gjykate.

